



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 1

2001

Janar

## P Ë R M B A J T J A

Ligj nr.8728 datë 18.1.2001	Për një ndryshim në ligjin nr.8081, datë 7.3.1996, “Për veprimtaritë e sigurimit dhe të risigurimit”, ndryshuar me ligjin nr.8458, datë 11.2.1999 dhe me ligjin nr.8606, datë 27.4.2000...	5
Ligj nr.8729 datë 18.1.2001	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7641, datë 1.12.1992 “Për miratimin me ndryshime të dekretit nr.295, datë 15.9.1992, “Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike, për përgjegjësinë ndaj personave të tretë” .....	5
Ligj nr.8730 datë 18.1.2001	Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të përmbaramit gjyqësor.....	10
Ligj nr.8731 datë 18.1.2001	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, të Këshillit të Ministrave nr.8, datë 28.12.2000, “Për përballimin e situatës emergjente hidroenergjetike” .....	20
Dekret nr.2862 datë 8.1.2001	Për lënie të shtetësisë shqiptare.....	21
Dekret nr.2864 datë 12.1.2001	Për lënie të shtetësisë shqiptare.....	22
Vendim i KM nr.9, datë 12.1.2001	Për disa shtesa e ndryshime në vendimin nr.406, datë 17.8.1993, të Këshillit të Ministrave, “Për riorganizimin e shërbimit të mbrojtjes së bimëve” .....	23

Vendim i KM nr.15, datë 12.1.2001	Për disa ndryshime në vendimin nr.60, datë 27.2.1992, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të ushtarakëve”, në vendimin nr.54, datë 27.2.1992, të Këshillit të Ministrave, “Për sistemin e pagave të Ministrisë së Rendit Publik dhe ushtarakëve të Ministrisë së Drejtësisë” dhe në vendimin nr.726, datë 21.12.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore” .....	24
Vendim i KM nr.17, datë 12.1.2001	Për miratimin e procedurës së tenderimit, për shitjen e paketës së aksioneve, prej 94 përqind, të zotëruar nga shteti në “Birra Malto”, sh.a., Tiranë, dhe për shpalljen fitues të tenderit kandidatin e radhës, “11 shoqëri shqiptare” .....	25
Vendim i KM nr.21, datë 20.1.2001	Për miratimin e planit të veprimit, për strategjinë kombëtare të strehimit .....	26
Vendim i KM nr.35, datë 20.1.2001	Për shërndarjen e këshillit të komunës Bërxullë, në qarkun e Tiranës .....	26
Vendim i KM nr.36, datë 20.1.2001	Për shpërblimin e punës në shoqëritë tregtare, me kapital tërësisht shtetëror, që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sektorin financiar .....	27
Vendim i KM nr.38, datë 26.1.2001	Për një mbrojtje të veçantë të personave, që ndihmojnë policinë, dhe të punonjësve të policisë, që u kërcënohet jeta, familja dhe prona, për shkak të detyrës .....	27
Vendim i KM nr.39, datë 26.1.2001	Për disa shtesa në vendimin nr.726, datë 21.12.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore” .....	29
Vendim i KM nr.40, datë 26.1.2001	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.198, datë 4.5.1993, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Entit Kombëtar të Banesave” .....	30
Vendim i KM nr.43, datë 26.1.2001	Për kalimin në pronësi pa shpërblim, të 51 përqind të aksioneve të shoqërisë “Shtypshkronja Tirana”, sh.a., në Tiranë, për Kryegjyshatën Botërore të Bektashinjve .....	31
Vendim i KM nr.49, datë 26.1.2001	Për skemën e shtyrjes së pagesës së TVSH-së dhe përcaktimin e kategorisë së eksportuesve, që përfitojnë rimbursimin, brenda 30 ditëve, të TVSh-së .....	31
Vendim i KM nr.50, datë 26.1.2001	Për miratimin e manualit kontabël të Bankës së Shqipërisë .....	33
Vendim i KM nr.51, datë 26.1.2001	Për shpronësimin, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, të cilat preken nga ndërtimi i superstradës Sukth-Durrës, në rrethin e Durrësit .....	34
Udhëzim nr.1 datë 12.1.2001	Një shtesë në udhëzimin nr.4, datë 22.8.1994, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e apartamenteve, që ndërtohen me fonde shtetërore” .....	38

**LIGJ**  
**Nr. 8728, datë 18.1.2001**

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8081, DATË 7.3.1996 “PËR VEPRIMTARITË E SIGURIMIT DHE TË RISIGURIMIT”, NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8458, DATË 11.2.1999 DHE ME LIGJIN NR.8606, DATË 27.4.2000**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**V E N D O S I:**

Neni 1

Në ligjin nr.8081, datë 7.3.1996 “Për veprimtaritë e sigurimit dhe të risigurimit”, ndryshuar me ligjin nr.8458, datë 11.2.1999 dhe me ligjin nr.8606, datë 27.4.2000, neni 15 shfuqizohet.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2875, datë 30.1.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani**

**LIGJ**  
**Nr. 8729, datë 18.1.2001**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7641, DATË 1.12.1992 “PËR MIRATIMIN ME NDRYSHIME TË DEKRETIT NR.295, DATË 15.9.1992 “PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM TË MBAJTËSVE TË MJETEVE MOTORIKE, PËR PËRGJEGJËSINË NDAJ PERSONAVE TË TRETË””**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**V E N D O S I:**

Neni 1

Në ligjin nr.7641, datë 1.12.1992 “Për miratimin me ndryshime të dekretit nr.295, datë 15.9.1992 “Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike, për përgjegjësinë ndaj personave të tretë”” bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Pas nenit 22 shtohet neni 22/1 me këtë përmbajtje:

#### “Neni 22/1

Në përputhje me parashikimet e bëra në këtë ligj krijohet Byroja Shqiptare e Sigurimit me statusin e entit publik. Kjo Byro është person juridik që nuk ka qëllime fitimi. Byroja Shqiptare e Sigurimit e ka selinë në Tiranë. Mbikëqyrja dhe kontrolli i Byrosë Shqiptare të Sigurimit kryhet nga Ministria e Financave.”

#### Neni 2

Pas nenit 22/1 shtohet neni 22/2 me këtë përmbajtje:

#### “Neni 22/2

Anëtarë të Byrosë Shqiptare të Sigurimit janë detyrimisht shoqëritë e sigurimeve, të autorizuara nga Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve, për të ushtruar veprimtarinë e sigurimeve motorike, për përgjegjësitë civile ndaj palëve të treta, që rrjedhin nga mbajtësit e mjeteve motorike.

Anëtarët e Byrosë Shqiptare të Sigurimit mbulojnë përgjegjësitë civile të të siguarve të tyre kur këta shkaktojnë aksidente.

Byroja Shqiptare e Sigurimit pajis anëtarët me Çertifikata Ndërkombëtare të Sigurimit (kartona jeshilë), sipas formës së miratuar nga Këshilli i Byrove.

Subjektet e autorizuara nga Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve, sipas nenit 65 të ligjit nr.8081, datë 7.3.1996 “Për veprimtaritë e sigurimit dhe të risigurimit”, marrin pjesë detyrimisht në Byronë Shqiptare të Sigurimeve, duke qenë subjekt i klauzolave të nenit 3 të këtij ligji. Anëtarët e përmendur më sipër nuk kanë të drejtë të shesin kartona të tjerë jeshilë, përveç atyre të emetuar dhe të lëshuar nga Byroja Shqiptare e Sigurimit.”

#### Neni 3

Pas nenit 23 shtohet neni 23/1, me këtë përmbajtje:

#### “Neni 23/1

Çdo anëtar i Byrosë Shqiptare të Sigurimit është përgjegjës për likuidimin e dëmit të shkaktuar nga mjetet e pajisura prej tij me Çertifikatë Ndërkombëtare Sigurimi (kartoni jeshil), sipas Marrëveshjes Uniforme, që ka nënshkruar Byroja Shqiptare e Sigurimit me byrotë e tjera. Në rast mospërbushjeje të detyrimit nga anëtari, Byroja Shqiptare e Sigurimit likuidon vetë dëmin dhe kërkon nga anëtari shumat përkatëse për detyrimin e papaguar.

Shumat e papaguara nga anëtarët, për të përmbushur detyrimet e tyre, të përfshira në paragrafin e parë të këtij neni, paguhet në favor të Byrosë Shqiptare të Sigurimit nga anëtarët që kanë mbetur, në përpjesëtim me të ardhurat nga primet e sigurimeve të detyrueshme të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësitë civile ndaj palëve të treta të vitit para ndodhjes së aksidentit.

Nëse një anëtar nuk përmbush detyrimet e përcaktuara në paragrafët e parë dhe të dytë të këtij neni, atëherë bëhet subjekt i sanksioneve të parashikuara në paragrafin e fundit të këtij neni.

Një anëtar, i cili lëshon kartona jeshilë, është i detyruar që brenda 25 ditëve nga data e mbylljes së muajit, gjatë të cilit janë lëshuar kartonat jeshilë, të paguajë në favor të Byrosë Shqiptare të Sigurimit pjesën e primit të barabartë në pjesën e përgjegjësisë që përballohet nga kjo byro, sipas përcaktimit të bërë në paragrafin e parë të këtij neni. Pjesa e kontributit përcaktohet me akt normativ të ministrit të Financave.

Kur ministri i Financave vëren shkelje të parashikimeve të paragrafit të mësipërm, gjobit anëtarin e Byrosë Shqiptare të Sigurimit, me dyfishin e kontributit të paderdhur. Në rast përsëritjeje ministri i Financave i kërkon Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve heqjen e autorizimit zyrtar për ushtrimin e veprimtarisë së sigurimeve, të përfshira në grupin 10 të sigurimeve, të përcaktuar në ligjin nr.8081, datë 7.3.1996 “Për veprimtaritë e sigurimit dhe të risigurimit.”

#### Neni 4

Pas nenit 23/1 shtohet neni 23/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 23/2

Masa e kontributit, që shoqëritë e sigurimit paguajnë për shpenzimet e ngritjes dhe të themelimit të Byrosë Shqiptare të Sigurimit, është 20 000 USD për secilin anëtar. Ky kontribut paguhet edhe nga anëtarët e rinj në çastin e pranimit të tyre.

Kontributet për shpenzimet e Byrosë Shqiptare të Sigurimit miratohen çdo vit nga ministri i Financave, pasi të ketë marrë më përpara mendimin e mbledhjes së përgjithshme të anëtarëve të kësaj Byroje dhe paguhet në përpjesëtim me të ardhurat nga primet e sigurimit të mbajtesve të mjeteve motorike për përgjegjësi civile ndaj palëve të treta.

Kur ministri i Financave vëren shkelje të parashikimeve të paragrafit të mësipërm, gjobit anëtarin e Byrosë Shqiptare të Sigurimit, me dyfishin e kontributit të paderdhur.”

#### Neni 5

Pas nenit 23/2 shtohet neni 23/3 me këtë përmbajtje:

“Neni 23/3

Për mbulimin e detyrimeve të Byrosë Shqiptare të Sigurimit që rrjedhin nga qarkullimi i mjeteve motorike të pasiguruara, si dhe për ndonjë detyrim tjetër, që vjen nga aksidentet e ndodhura në Shqipëri ose jashtë saj, të shkaktuara nga mjetet e huaja ose shqiptare, përkatësisht, krijohet fondi i kartonit jeshil.

Masa e kontributit, që çdo anëtar do të derdhë në këtë fond, caktohet çdo vit nga ministri i Financave, pasi të ketë marrë më parë mendimin e mbledhjes së përgjithshme të anëtarëve. Masa e kontributit del në bazë të primeve të sigurimit të kartonit jeshil, të arkëtuara gjatë vitit të mëparshëm ushtrimor. Shuma e kontributit, në këtë rast, për çdo anëtar nuk mund të jetë më e vogël se 100 000 USD.

Kur Ministri i Financave vëren shkelje të parashikimeve të paragrafit të dytë të këtij neni, gjobit anëtarin e Byrosë Shqiptare të Sigurimit, në masën e kontributit të paderdhur. Në rast përsëritjeje, ministri i Financave i kërkon Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve heqjen e autorizimit zyrtar për ushtrimin e veprimtarisë së sigurimeve, të përfshirë në grupin 10 të sigurimeve, i përcaktuar në ligjin nr.8081, datë 7.3.1996 “Për veprimtaritë e sigurimit dhe të risigurimit”.”

#### Neni 6

Pas nenit 23/3 shtohet neni 23/4 me këtë përmbajtje:

“Neni 23/4

Organet drejtuese të Byrosë Shqiptare të Sigurimit janë:

Mbledhja e përgjithshme e anëtarëve

Këshilli administrativ

Këshilli administrativ përbëhet nga 10 anëtarë, 9 prej të cilëve zgjidhen nga mbledhja e përgjithshme e anëtarëve, ndërsa një emërohet nga ministri i Financave. Ky i fundit nuk ka të drejtë vote. Këshilli administrativ zgjedh kryetar njërin prej anëtarëve të tij.

Mbledhja e parë e përgjithshme e anëtarëve të Byrosë Shqiptare të Sigurimit thirret nga ministri i Financave.

Brenda muajit dhjetor të çdo viti, ministri i Financave, me akt të veçantë përcakton numrin e votave për secilin anëtar. Numri i votave caktohet në përpjesëtim me kontributin e anëtarëve në fondin e kompensimit dhe në fondin e kartonit jeshil.

Këshilli administrativ është i detyruar që, deri në fund të nëntorit të çdo viti, të dorëzojë te ministri i Financave listën vjetore të kontributit të anëtarëve në fondin e kompensimit dhe në fondin e kartonit jeshil.

Derisa ministri i Financave të nxjerrë aktin normativ, çdo anëtar ka të drejtën e votës në mbledhjen e përgjithshme të anëtarëve, në raportin: një votë e barabartë me dhjetë milionë lekë të primeve të sigurimit të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësitë civile ndaj palëve të treta, të arkëtuara në vitin paraardhës. Anëtarët, që kanë të ardhura më të ulta se dhjetë milionë lekë, kanë të drejtën vetëm të një vote, pavarësisht nga shumta e të ardhurave që ata kanë realizuar në çastin kur del akti normativ.”

#### Neni 7

Në paragrafin e parë të nenit 24, pas fjalëve “... administrimin e fondit të kompensimit”, shtohen fjalët “, si dhe të fondit të kartonit jeshil”.

#### Neni 8

Neni 26 ndryshohet si vijon:

“Organizimi, funksionimi dhe fusha e veprimtarisë së Byrosë Shqiptare të Sigurimit rregullohen me dispozitat e këtij ligji, si dhe në bazë të statutit të saj.

Statuti i Byrosë Shqiptare të Sigurimit dhe ndryshimet e tij miratohen nga ministri i Financave.”

#### Neni 9

Pas nenit 26 shtohet neni 26/1, me këtë përmbajtje:

#### “Neni 26/1

Në rastet kur tërhiqet autorizimi zyrtar për grupin 10 të sigurimit, anëtari nuk ka të drejtë të bëjë kërkesë për autorizim të ri, kur në rastin e tërheqjes nuk ka shlyer detyrimet e mëparshme dhe pa kaluar një vit nga data e tërheqjes.

Kur një shoqëri sigurimi, anëtare e Byrosë, falimenton ose i është hequr autorizimi zyrtar për grupin 10 të sigurimeve ose për ndonjë shkak tjetër, që e bën të pamundur ushtrimin e veprimtarisë në këtë grup sigurimi, Byroja Shqiptare e Sigurimit ushtron të gjitha të drejtat dhe detyrimet e siguresit anëtar, për grupin 10, sipas përcaktimeve të ligjit nr.8081, datë 7.3.1996 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit.”

#### Neni 10

Pas nenit 26/1 shtohet neni 26/2, me këtë përmbajtje:

#### “Neni 26/2

Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e INSIG-ut, sh.a., që kanë të bëjnë me ushtrimin e funksioneve të Byrosë Shqiptare të Sigurimit, i kalojnë kësaj të fundit.

Ministri i Financave përcakton dhe vendos mënyrat, afatet dhe procedurat për kalimin te Byroja Shqiptare e Sigurimit të të drejtave dhe të detyrimeve të INSIG-ut, sh.a., në ushtrimin kalimtar, nga ana e tij, të funksioneve të kësaj Byroje.

Aktet e nxjerra nga ministri i Financave janë të detyrueshme për të gjitha palët e interesuara.”

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2876, datë 30.1.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Rexhep Meidani**

**LIGJ  
Nr. 8730, datë 18.1.2001**

**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT TË PËRMBARIMIT  
GJYQËSOR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
V E N D O S I:**

**KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

**Objekti i ligjit**

Ky ligj përcakton:

- a) rregullat e organizimit dhe të funksionimit të Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor;
- b) kriteret që duhet të përmbushin shtetasit që të emërohen përmbartues gjyqësorë;
- c) statusin dhe procedimin disiplinor të përmbartuesit gjyqësor;
- ç) marrëdhëniet me institucionet shtetërore dhe me subjektet e tjera publike dhe private.

Neni 2

**Objekti i veprimtarisë**

1. Shërbimi i Përmbartimit Gjyqësor ka për mision ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë, në rastet e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile.
2. Shërbimi i Përmbartimit Gjyqësor i ushtron funksionet nëpërmjet përmbartuesve gjyqësorë.

Neni 3

**Organizimi**

Shërbimi i Përmbartimit Gjyqësor ka organizim unik dhe të centralizuar, me shtrirje në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 4  
**Parimet e veprimtarisë**

Ligjshmëria dhe objektiviteti, si dhe respektimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me ligj subjekteve që marrin pjesë në ekzekutim, janë parimet bazë të punës së Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor.

Neni 5  
**Përmbarruesi gjyqësor**

1. Përmbarruesi gjyqësor është personi i ngarkuar me ligj për kryerjen e veprimtarisë së vënies në ekzekutim të titujve ekzekutivë, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.
2. Në ushtrimin e veprimtarisë së tij përmbarruesi gjyqësor duhet të karakterizohet nga ndershmëria, paaënësia dhe profesionalizmi.
3. Përmbarruesi gjyqësor në ushtrimin e veprimtarisë së tij përfaqëson autoritetin shtetëror.

**KREU II**  
**ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I SHËRBIMIT TË PËRMBARRIMIT GJYQËSOR**

Neni 6  
**Nivelet e organizimit**

Shërbimi i Përmbarrimit Gjyqësor varet nga ministri i Drejtësisë dhe organizohet në nivel qendror dhe vendor, si vijon:

- a) Drejtoria e Përgjithshme përbën nivelin qendror të organizimit.
- b) Zyrat përmbarrimore, brenda juridiksionit të çdo rrethi gjyqësor të shkallës së parë, përbëjnë nivelin vendor të organizimit dhe varen administrativisht nga Drejtoria e Përgjithshme.

Neni 7  
**Drejtori i Përgjithshëm**

1. Drejtori i përgjithshëm përgjigjet për drejtimin, bashkërendimin dhe kontrollin e Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor.
2. Drejtori i përgjithshëm emërohet dhe shkarkohet nga Kryeministri, me propozimin e ministrit të Drejtësisë.

Neni 8  
**Përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm**

Drejtori i përgjithshëm ka këto përgjegjësi:

- a) Drejton dhe kontrollon veprimtarinë e Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor.
- b) Siguron zbatimin e njëjtë të akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe të praktikave në fushën e veprimtarisë procedurale të ekzekutimit.
- c) Përgatit dhe nxjerr urdhra, udhëzime të brendshme dhe metodika për trajtimin në përgjithësi të çështjeve në ekzekutim.
- ç) I propozon ministrit të Drejtësisë emërimin dhe shkarkimin e kryetarëve të zyrave përmbarrimore.
- d) Kontrollon dokumentimin e veprimtarisë përmbarrimore.
- dh) Organizon dhe ndjek edukimin profesional dhe trajnimin e përmbarruesve gjyqësorë.
- e) Ndjek zbatimin e etikës profesionale gjatë veprimtarisë përmbarrimore.
- ë) Përfaqëson Shërbimin e Përmbarrimit Gjyqësor në marrëdhënie me të tretët.
- f) Ushtron përgjegjësi të tjera të përcaktuara me ligj.

Neni 9  
**Organizimi i zyrave përbarimore**

1. Zyrat përbarimore pranë çdo rrethi gjyqësor përbëhen nga:
  - a) kryetari i zyrës;
  - b) përbaruesit gjyqësorë;
  - c) personeli administrativ dhe teknik.
2. Çdo zyrë përbarimore është person juridik dhe ka vulën e vet.

Neni 10  
**Organika**

1. Numri i përgjithshëm i përbaruesve gjyqësorë të Shërbimit të Përbarimit Gjyqësor caktohet nga kryeministri, me propozimin e ministrit të Drejtësisë.
2. Struktura e Drejtorisë së Përgjithshme dhe e zyrave përbarimore, organikat e tyre, si dhe rregullat e hollësishme për funksionimin e Shërbimit të Përbarimit Gjyqësor përcaktohen nga ministri i Drejtësisë, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm.

Neni 11  
**Burimet financiare**

1. Për realizimin e detyrave, Shërbimi i Përbarimit Gjyqësor ka buxhetin e vet, si pjesë të veçantë brenda buxhetit të Ministrisë së Drejtësisë.
2. Shërbimi i Përbarimit Gjyqësor ka të drejtë të përdorë të ardhura të tjera që lejohen me ligj.

Neni 12  
**Sigurimi i të ardhurave nga veprimtaria përbarimore**

1. Çdo veprim përbarimor kryhet vetëm kundrejt pagimit të tarifave përkatëse.
2. Tarifat përbarimore përcaktohen me akt normativ të ministrit të Drejtësisë.
3. Ndarja e të ardhurave, kriteret e procedurat e administrimit dhe të shpërndarjes së të ardhurave përcaktohen me urdhër të përbashkët të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave.

KREU III  
**KËSHILLI I PËRMBARIMIT**

Neni 13  
**Përbërja**

1. Këshilli i Përbarimit përbëhet nga sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë, drejtori i përgjithshëm i Shërbimit të Përbarimit Gjyqësor, drejtori i Drejtorisë së Personelit, Organizimit dhe Shërbimeve në Ministri, kryetari i Zyrës Përbarimore të Tiranës dhe një këshilltar i ministrit të Drejtësisë.
2. Rregullat për funksionimin e Këshillit të Përbarimit dhe procedurat që ndjek ai përcaktohen nga ministri i Drejtësisë, pasi të ketë marrë mendimin e këtij Këshilli.

Neni 14  
**Përgjegjësitë e Këshillit të Përbarimit**

1. Këshilli i Përbarimit zhvillon konkurs për emërimin e përbaruesve gjyqësorë dhe shqyrton shkeljet disiplinore të kryera prej tyre.

2. Këshilli i Përmbarrimit bën çdo vit vlerësimin e aftësive profesionale të përmbarruesve gjyqësorë, bazuar në kriteret e cilësisë, të vëllimit të punës, të shpejtësisë dhe të figurës së tyre morale, si më poshtë:

shumë mirë  
mirë  
pranueshëm  
i paaftë

Sistemi i vlerësimit të punës së përmbarruesve gjyqësorë përcaktohet nga ministri i Drejtësisë, me propozimin e drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor, pasi të jetë marrë mendimi i Këshillit të Përmbarrimit.

3. Këshilli i Përmbarrimit ka funksion këshillimor dhe ia paraqet, në çdo rast, mendimin e vet ministrit të Drejtësisë, i cili duhet të shprehet brenda 30 ditëve nga kjo paraqitje.

#### KREU IV STATUSI I PËRMBARRUESIT GJYQËSOR

##### Neni 15

##### **Emërimi i përmbarruesit gjyqësor**

1. Emërohet përmbarrues gjyqësor shtetasi shqiptar që plotëson këto kushte:

Ka zotësi të plotë për të vepruar.

Ka kryer arsimin e lartë juridik.

Gëzon figurë të pastër morale.

ç) Nuk është i dënuar për kryerjen e një vepre penale me vendim gjyqësor të formës së prerë.

d) Nuk është larguar nga administrata publike për shkelje disiplinore brenda një afati prej 3 vjetësh nga data e depozitimit të kërkesës; kur shkelja disiplinore është kryer gjatë ushtrimit të funksionit si gjyqtar, prokuror, oficer i policisë gjyqësore, noter ose avokat, afati është 5 vjet.

2. Pranimi në Shërbimin e Përmbarrimit Gjyqësor bëhet me konkurs. Këshilli i Përmbarrimit ndjek procedurat e paraqitjes, të përzgjedhjes dhe të vlerësimit të kandidaturave dhe mendimin e vet ia paraqet ministrit të Drejtësisë brenda 15 ditëve.

3. Konkurruesi fitues emërohet përkohësisht përmbarrues gjyqësor nga ministri i Drejtësisë, për një periudhë prove 3-mujore.

##### Neni 16

##### **Periudha e provës**

1. Gjatë periudhës së provës, përmbarruesi gjyqësor është nën kujdesin e një përmbarruesi të vjetër në detyrë dhe vlerësohet nga eprori i tij. Veprimtaritë e trajnimit janë të detyrueshme për përmbarruesin gjyqësor në periudhën e provës.

2. Në fund të periudhës së provës, ministri i Drejtësisë, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm, vendos:

emërimin përfundimtar si përmbarrues gjyqësor;

largimin nga Shërbimi i Përmbarrimit Gjyqësor.

3. Në rastin e pikës 2 shkronja "b" të këtij neni, personi përkatës gëzon të drejtat e përmbarruesit gjyqësor vetëm për periudhën e kohës së provës.

##### Neni 17

##### **Papajtueshmëritë**

1. Përmbarruesi gjyqësor nuk mund të ushtrorë asnjë detyrë ose veprimtari tjetër publike, me përfundim të atyre edukative e të mësimdhënies.

2. Ai nuk duhet të jetë në marrëdhënie pune ose të kryejë veprimtari të tjera, të cilat paraqesin konflikt interesash me detyrën që ka ose pengojnë përmbushjen e saj.

3. Përmbauesi gjyqësor nuk duhet të jetë anëtar i organeve qendrore ose ekzekutive të partive politike.

#### Neni 18

#### **Përbashkrimi i përmbauesit gjyqësor**

1. Përmbauesi gjyqësor është i detyruar të heqë dorë nga ekzekutimi i çështjes kur:

a) ka interes në çështje ose në një mosmarrëveshje tjetër që ka lidhje me atë në ekzekutim;

b) ai vetë ose bashkëshortja është i afërt deri në shkallë të katërt, ose ka krushqi, deri në shkallë të dytë, ose është i lidhur me detyrime birësimi ose bashkëjeton, në mënyrë të përhershme me njërin nga palët ose nga mbrojtësit;

c) ai vetë ose bashkëshortja është në konflikt gjyqësor ose në armiqësi, ose në marrëdhënie kredie ose huaje me njërin prej palëve, ose me njërin prej përfaqësuesve;

ç) është kujdestar, punëdhënës i njërit prej palëve, administrator ose ka një detyrë tjetër në një ent, shoqatë, shoqëri ose institucion tjetër, që kanë interesa për çështjen në ekzekutim;

d) vërtetohen, në çdo rast tjetër, sipas rrethanave konkrete, arsye serioze njëanshmërie.

2. Kërkesa për heqjen dorë i paraqitet për vendim kryetarit të zyrës përkatëse përmbaimore. Në rastin e heqjes dorë nga kryetari i zyrës përmbaimore, kërkesa i paraqitet për vendim drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit të Përmbaimit Gjyqësor. Përmbajtja e kërkesës u njoftohet palëve.

#### Neni 19

#### **Heqja dorë e përmbauesit gjyqësor**

1. Përmbauesi gjyqësor, i cili vlerëson me ndërgjegje se ka arsye për të mos marrë pjesë në ekzekutimin e një çështjeje, i kërkon të zëvendësohet kryetarit të zyrës përmbaimore. Kryetari i zyrës përmbaimore, kur e sheh me vend kërkesën, urdhëron zëvendësimin e tij me një tjetër përmbaues gjyqësor të asaj zyre.

2. Për kryetarin e zyrës përmbaimore zëvendësimi urdhërohet nga drejtori i përgjithshëm.

#### Neni 20

#### **Të drejtat**

Përmbauesit gjyqësorë gëzojnë edhe këto të drejta:

a) Marrin pjesë në sindikata ose shoqata profesionale.

b) Përfitojnë trajtim shëndetësor dhe sigurime shoqërore për vete dhe për pjesëtarët e familjes që kanë në ngarkim, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

c) U paguhen shpenzimet për udhëtime pune, sipas kriterëve dhe masës së parashikuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

ç) Trajtohen nga shteti për ngritjen e nivelit të tyre profesional.

#### Neni 21

#### **Detyrat**

Përmbauesit gjyqësorë janë të detyruar:

a) të njohin, të respektojnë dhe të zbatojnë Kushtetutën, Kodin e Procedurës Civile, Kodin Civil dhe akte të tjera ligjore e nënligjore, që lidhen me veprimtarinë përmbaimore, si dhe urdhrat, udhëzimet dhe metodikat e drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit të Përmbaimit Gjyqësor;

b) të përsosin aftësitë profesionale dhe të marrin pjesë në veprimtaritë trajnuese të organizuara për këtë qëllim.

Neni 22  
**Paga dhe shpërblimet**

1. Paga e përmbaruesit gjyqësor përbëhet nga paga bazë, shtesa mbi pagë dhe shpërblimi i posaçëm.

2. Pagat e punonjësve të përmbarimit gjyqësor përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Përmbaruesi gjyqësor, në varësi të rezultateve të punës, mund të përfitojë një shpërblim, i cili përballohet nga të ardhurat që realizohen, administrohen dhe shpërndahen sipas pikës 3 të nenit 12 të këtij ligji.

4. Përmbaruesi gjyqësor, në varësi të rezultateve në punë, mund të përfitojë një shpërblim, i cili përballohet nga të ardhurat që i mbeten Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor, në përputhje me nenin 12 të këtij ligji. Shpërblimi i posaçëm caktohet, në çdo rast, me urdhër të ministrit të Drejtësisë.

Neni 23  
**Koha e punës**

1. Kohëzgjatja javore e punës dhe orari, si rregull, janë të njëjta me ato të administratës publike.

2. Për nevoja pune, me urdhër të eprorit të drejtpërdrejtë, përmbaruesi gjyqësor është i detyruar të punojë edhe jashtë orarit të punës, në ditët e pushimit javor, në ditët e festave ose edhe kur është me lejen vjetore.

3. Kriteret dhe masa e pagesës për punën jashtë kohëzgjatjes javore dhe orarit të zakonshëm caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 24  
**Lejet**

1. Përmbaruesit gjyqësorë gëzojnë të drejtën e një lejeje vjetore të pagueshme prej 4 javësh kalendarike. Leja vjetore bëhet në muajt korrik-gusht. Në rastet kur përmbaruesi gjyqësor në periudhën korrik-gusht ngarkohet me kryerjen e detyrave të ngutshme ose kur ndërpret lejen për nevoja pune, përveç ditëve të pushimit të mbetura, përmbaruesi gjyqësor përfiton deri në 5 ditë pushimi shtesë.

2. Për nevoja të veçanta vetjake ose familjare, përmbaruesi gjyqësor ka të drejtë të përfitojë leje të papaguar deri në 20 ditë në muaj, por jo më tepër se 30 ditë në vit.

3. Në raste martesash ose vdekjesh brenda familjes, kur është konsumuar koha e parashikuar në pikën 2 të këtij neni, përmbaruesi gjyqësor ka të drejtë të përfitojë deri në 10 ditë leje.

Neni 25  
**Identifikimi**

1. Përmbaruesi gjyqësor ka dokument identifikues, të cilin e paraqet në çdo rast të kryerjes së detyrës. Dokumenti përdoret vetëm gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të saj.

2. Përcaktimi i dokumentit identifikues bëhet me urdhër të ministrit të Drejtësisë.

Neni 26  
**Mbledhja dhe administrimi i të dhënave**

1. Përmbaruesi gjyqësor ka të drejtë dhe merr masa për mbledhjen, administrimin dhe ruajtjen e të dhënave që lidhen ngushtë me nevojat e ushtrimit të funksioneve e të detyrave të ngarkuara, duke respektuar garancitë kushtetuese dhe ligjore për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

2. Organet e administratës publike dhe të sistemit të drejtësisë, entet publike, si dhe personat fizikë e juridikë që kanë dokumente dhe të dhëna që lidhen me ekzekutimin, janë të detyruar t'i paraqesin kur u kërkohen nga përmbauesit gjyqësorë.

3. Të dhënat e marra në përputhje me këtë nen grumbullohen, administrohen, ruhen dhe/ose asgjësohen, në përputhje me dispozitat përkatëse në fuqi.

#### Neni 27

### **Mbrojtja e veçantë e përmbauesit gjyqësor**

Kur përmbauesit gjyqësor, gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të saj, i rrezikohet jeta, familja ose i dëmtohet prona, shteti i garanton mbrojtje të veçantë, kushtet dhe mënyrat e përfitimit të së cilës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### Neni 28

### **Komandimi**

1. Për nevoja të punës, pranë një zyre përmbaimore, mund të caktohet një përmbaues gjyqësor i zyrës përmbaimore më të afërt me të për ekzekutimin e një numri titujsh ekzekutivë.

2. Përmbauesit gjyqësor mund t'i kërkohet të lëvizë në një zyrë tjetër të afërt përmbaimore jo më shumë se 2 periudha në vit, deri në 3 muaj secila. Në fund të këtij afati, përmbauesi gjyqësor kthehet përsëri në vendin e tij të mëparshëm.

3. Caktimi dhe lëvizja urdhërohen nga drejtori i përgjithshëm i Shërbimit të Përmbaimit Gjyqësor, pasi të ketë dëgjuar përmbauesin gjyqësor.

#### Neni 29

### **Pezullimi dhe ruajtja e vendit të punës**

1. Përmbauesi gjyqësor mund të pezullohet nga detyra me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Përmbaimit Gjyqësor, kur ndaj tij fillon ndjekje penale, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar.

2. Përmbauesit gjyqësor i ruhet vendi i punës:

gjatë periudhës së thirrjes nën armë;

b) për periudha studimi, kur drejtori i përgjithshëm jep miratimin.

3. Përmbauesi gjyqësor nuk paguhet gjatë periudhës së parashikuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni. Në rastin e parashikuar në pikën 1, kur çështja penale pushohet ose kur me vendim gjykate të formës së prerë deklarohet i pafajshëm, përmbauesit gjyqësor i jepet paga bazë që nga çasti i pezullimit.

4. Periudha e parashikuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni mbahet parasysh për llogaritjen e vjetërsisë në shërbim.

#### Neni 30

### **Bashkëpunimi me organet e tjera**

1. Përmbauesi gjyqësor, për kryerjen e detyrave të ngarkuara, bashkëpunon me Policinë e Shtetit, me Policinë Ndërtimore dhe policinë e tjera, me organet e pushtetit vendor dhe prefekturat.

2. Organet shtetërore ose publike janë të detyruara të ndihmojnë përmbauesin gjyqësor në ushtrimin e funksioneve, sipas ligjit, sa herë që kërkohet ndihma e tyre.

3. Policia e Shtetit dhe ajo Ndërtimore vë në dispozicion të përmbauesit gjyqësor mjete dhe forca të mjaftueshme për ushtrimin e funksioneve të tij, sipas ligjit. Rregulla të hollësishme për përmbushjen e detyrave sipas kësaj pike caktohen me akte të përbashkëta të ministrit të Drejtësisë me titullarët e institucioneve përkatëse.

4. Kërkesa për dhënien e ndihmës pranë këtyre organeve bëhet nga kryetari i zyrës përbarimorë në rrethin gjyqësor dhe shpenzimet e kryera trajtohen sipas procedurave ligjore për ekzekutimin e detyrueshëm.

## KREU V DISIPLINA DHE LARGIMI

### Neni 31 **Masat disiplinore**

1. Përmbaruesi gjyqësor, që shkel rregullat e parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore që lidhen me detyrën e tij ose nuk i zbaton ato, kur nuk ka vend për përgjegjësi penale, ndëshkohet me një të një nga këto masa disiplinore:

Vërejtje me shkrim

Vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra

Shkarkim nga detyra.

2. Procedimi disiplinor fillon jo më vonë se 30 ditë nga çasti i vënies re të shkeljes dhe jo më vonë se 1 vit nga çasti i kryerjes së saj.

3. Nismën për fillimin e procedimit disiplinor e ndërmerr drejtori i përgjithshëm i Shërbimit të Përbarimit Gjyqësor. Këshilli i Përbarimit jep mendimin e tij brenda 15 ditëve nga fillimi i procedimit.

### Neni 32 **Dhënia e masës disiplinore dhe shlyerja e saj**

1. Masat disiplinore jepen me urdhër të ministrit të Drejtësisë dhe shënohen në dosjen vetjake. Masat disiplinore jepen në mënyrë të shkallëzuar ose në bazë të rëndësisë së shkeljes dhe të pasojave. Për çdo shkelje jepet vetëm një masë disiplinore.

2. Përmbaruesi gjyqësor detyrohet të zhëdmojë dëmin e shkaktuar, sipas dispozitave në fuqi.

3. Masat e mësipërme jepen sipas një procedure administrative që garanton të drejtën për të marrë të dhëna, për t'u dëgjuar, për t'u mbrojtur dhe për t'u ankuar. Vendimi për marrjen e masës disiplinore i komunikohet me shkrim të interesuarit.

4. Masat e përcaktuara në nenin 31, me përjashtim të shkronjës "c", mund të shlyhen nëse brenda një viti nga data e dhënies së tyre, ndaj përmbaruesit gjyqësor nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore. Masat disiplinore të shlyera hiqen nga dosja vetjake.

### Neni 33 **Ankimi**

Kundër dhënies së masave disiplinore të parashikuara në pikën 1 të nenit 31 mund të bëhet ankimi në gjykatë, sipas rregullave të parashikuara në nenin 328 të Kodit të Procedurës Civile.

### Neni 34 **Largimi**

1. Përmbaruesi gjyqësor largohet nga detyra në këto raste:

a) kur mbush moshën për pension;

b) kur bëhet i paaftë nga ana shëndetësore për një periudhë kohe mbi një vit;

c) kur humbet zotësinë për të vepruar;

- ç) kur kërkon ai vetë;
  - d) kur shkurtohet funksioni organik;
  - dh) kur është pranuar në kundërshtim me kriteret e vendosura në këtë ligj.
2. Largimi i përmbaruesit gjyqësor bëhet nga ministri i Drejtësisë.

Neni 35  
**Shkarkimi**

1. Përmbaruesi gjyqësor shkarkohet nga detyra në këto raste:
- kur dënohet për kryerjen e një vepre penale;
  - kur kryen shkelje të rënda të disiplinës në punë;
  - c) kur kryen në mënyrë të përsëritur thyerje të disiplinës dhe nuk i është hequr masa e dhënë më parë;
  - ç) kur provohet se ka përdorur funksionin e tij në shërbim të interesave vetjake ose të personave me të cilët ka lidhje familjare;
  - d) kur provohet se me veprimet ose mosveprimet e tij ka krijuar favore të padrejta për persona të tjerë;
  - dh) kur nuk përmbush veprimet përmbarimore të parashikuara në ligj;
  - e) kur është vlerësuar “i paaftë” në përputhje me pikën 2 të nenit 14 të këtij ligji.
2. Shkarkimi i përmbaruesit gjyqësor bëhet nga ministri i Drejtësisë.

KREU VI  
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 36  
**Riorganizimi i Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor**

Brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji duhet të përfundojë riorganizimi i Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor, në përputhje me rregullat e caktuara në këtë ligj.

Neni 37  
**Dispozitë kalimtare**

Për përmbaruesin gjyqësor, që në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji është duke vazhduar studimet në fakultetin juridik, kriteret e vendosura në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 15 dhe në shkronjën “dh” të pikës 1 të nenit 34 të këtij ligji zbatohen pas mbarimit të periudhës kohore që përfshin vitet që i kanë mbetur për përfundimin e studimeve në fakultetin juridik, plus një vit. Deri në përfundim të kësaj periudhe ai është përmbarues gjyqësor në periudhë prove dhe për të zbatohen rregullat e nenit 16 të këtij ligji.

Neni 38  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2877, datë 30.1.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Rexhep Meidani**

**LIGJ**  
**Nr. 8731, datë 18.1.2001**

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE NR.8, DATË 28.12.2000 “PËR PËRBALLIMIN E SITUATËS EMERGJENTE  
HIDROENERGJETIKE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 101 të Kushtetutës,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
V E N D O S I:**

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, i Këshillit të Ministrave nr.8, datë 28.12.2000  
“Për përballimin e situatës emergjente hidroenergjetike”.

**Shpallur me dekretin nr.2878, datë 30.1.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Rexhep Meidani**

**DEKRET**  
**Nr. 2862, datë 8.1.2001**

**PËR LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92 pika “c”, të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389,  
datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e ministrit të Rendit Publik,

**D E K R E T O J:**

Neni 1

U hiqet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Gazmend Nevruz Iljazi
2. Vili Sulejman Mulla
3. Pavli Kristaq Llakmani
4. Bashkim Seit Pajo
5. Ildir Zenel Hysa
6. Meri Aleksandër Vila
7. Erion Bujar Basha
8. Shpend Nebi Bakiri
9. Mimoza Midat Boçari (Boçari)
10. Lina Aleko Rada
11. Ana Aleko Rada
12. Ivi (Ives) Gëzim Selenica
13. Bledi Daut Zelo
14. Erion Agim Metani
15. Napolon Telo (Aristotel) Stefani
16. Fatosh Meço Amataj

17. Arian Bajram Selimaj
18. Sabina Arian Selimaj
19. Sarah Arian Selimaj
20. Najada Agim Selimaj (Lumi)
21. Gentiana Nexhmi Kusch (Zoto)
22. Arben Mehmet Golemi
23. Marjana (Mariana) Zisi Canaj (Janko)
24. Evis Agron Canaj
25. Zhaklina Agron Canaj
26. Daniel Agron Canaj
27. Anila Tonin Kretz (Shkupa)
28. Zhylien Hajredin Elmazi
29. Jup Jusuf Vorfa
30. Mirela Bashkim Shehu (Kozeli)
31. Fatjon Bashkim Shehu
32. Bashkim Refat Shehu
33. Françesko Adem Gjata
34. Lulëzim Adem Gjata
35. Stephanie Lulëzim Gjata
36. Jessica Lulëzim Gjata

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
**Rexhep Meidani**

**DEKRET**  
**Nr. 2864, datë 12.1.2001**

**PËR LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, dsatë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e ministrit të Rendit Publik,

**D E K R E T O J:**

Neni 1

I hiqet shtetësia shqiptare me kërkesë të tij qytetarit:

1. Boris Bajram Bilani

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
**Rexhep Meidani**

**VENDIM**  
**Nr. 9, datë 12.1.2001**

**PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.406, DATË 17.8.1993, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR RIORGANIZIMIN E SHËRBIMIT TË MBROJTJES SË BIMËVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 50, të ligjit nr.7662, dastë 19.1.1993, “Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

Në vendimin nr.406, datë 17.8.1993, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet si vijon:

“ Në Drejtorinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit, në çdo rreth, caktohen inspektorët e mbrojtjes së bimëve, numri i të cilëve përcaktohet në përputhje me aktet nënligjore, për miratimin e organikave dhe të numrit të punonjësve.

Laboratorët e mbrojtjes së bimëve ngrihen dhe funksionojnë mbi bazë zonale. Numri i zonave dhe vendndodhja e laboratorëve përcaktohet me urdhër të ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit.”.

2. Fjala e parë e paragrafit të dytë, në pikën 3, ndryshohet si vijon:

“Inspektorët e karantinës së jashtme bimore e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në pikat doganore, kufitare. Ata janë pjesëtarë të grupit të praktikës, që bën kontaktin e parë.”.

3. Pika 5 ndryshohet si vijon:

“Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit të marrë masat për ngritjen dhe plotësimin e laboratorit qendror të karantinës bimore dhe të laboratorit të kontrollit cilësor shtetëror të produkteve për mbrojtjen e bimëve (PMB), në Institutin e Mbrojtjes së Bimëve, të zyrave të inspektimit karantinor fitosanitar, në pikat doganore, kufitare, dhe të laboratorëve zonale të mbrojtjes së bimëve.”.

4. Pika 6 shfuqizohet.

5. Pika 9 ndryshohet si vijon:

“Pagesat për shpenzimet administrative të regjistrimit të PMB-ve, shpenzimet për analizat cilësore të tyre, gjatë procedurave të regjistrimit dhe pas hedhjes në treg, dhe shpenzimet për kryerjen e provave biologjike-agronomike bëhen nga llogaria e thesarit për Institutin e Mbrojtjes së Bimëve. Ato administrohen sipas akteve, ligjore dhe nënligjore, në fuqi, për investime dhe shërbime operative në laboratorin e kontrollit cilësor shtetëror të PMB-ve dhe për shpërblimin e anëtarëve të Komisionit Shtetëror të Regjistrimit të PMB-ve.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**

**VENDIM**  
**Nr. 15, datë 12.1.2001**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.60, DATË 27.2.1992, TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE, “PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHTESA MBI PAGË TË**  
**USHTARAKËVE”, NË VENDIMIN NR.54, DATË 27.2.1992, TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE, “PËR SISTEMIN E PAGAVE TË MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK DHE**  
**USHTARAKËVE TË MINISTRISË SË DREJTËSISË” DHE NË VENDIMIN NR.726, DATË**  
**21.12.2000, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË**  
**INSTITUCIONEVE BUXHETORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999, “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, dhe të ligjit nr.8718, datë 19.12.2000, “Për buxhetin e shtetit të vitit 2001”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I :**

I. Të rriten pagat e ushtarakëve, të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Ministrisë së Rendit Publik, në masën 10 për qind.

II. Në vendimin nr.60, datë 27.2.1992, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesat mbi pagë të ushtarakëve”, bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1, niveli më i ulët i pagës së ushtarakut aktiv të jetë 7720 lekë në muaj, kurse niveli më i lartë (drejtor drejtorie) të jetë 32 670 lekë në muaj.

b) Në pikën 2, paga e ushtarakut të shërbimit aktiv, e nxënësve dhe e studentëve ushtarakë të jetë deri 930 lekë në muaj.

c) Në pikën 5, paragrafi i tretë, paga për ushtarin rezervist të jetë deri 666 lekë në ditë.

Ç) Paga mujore për funksionet e mëposhtme të bëhet:

- Shef i Shtabit të Përgjithshëm 77 865 lekë

- Zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm 61 090 lekë

- Drejtor i përgjithshëm 63 355 lekë

- Shef i kabinetit të ministrit (ushtarak) 59 630 lekë

- Këshilltar i ministrit (ushtarak) 50 180 lekë

III. Në vendimin nr.54, datë 27.2.1992, të Këshillit të Ministrave, “Për sistemin e pagave të Ministrisë së Rendit Publik, dhe ushtarakëve të Ministrisë së Drejtësisë”, bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1, niveli më i ulët i pagës bazë të ushtarakut të sistemit të Ministrisë së Rendit Publik, të jetë 7 720 lekë në muaj dhe niveli më i lartë (drejtor drejtorie) të jetë 33614 lekë në muaj, ndërsa niveli më i ulët dhe më i lartë për ushtarakun e sistemit të Ministrisë së Drejtësisë të mbetet i pandryshuar, përkatësisht 7 018 lekë në muaj dhe 30 558 lekë në muaj.

b) Në pikën, paga e ushtarëve të shërbimit të detyrueshëm dhe e studentëve të shkollave të Ministrisë së Rendit Publik të jetë deri në 930 lekë në muaj.

c) Për ushtarakët e Ministrisë së Rendit Publik, paga e të cilëve është përcaktuar me vendime të veçanta të Këshillit të Ministrave (jashtë sistemit të pagave me klasa) pagat rriten me 10 për qind.

ç) Paga mujore për funksionet e mëposhtme bëhet:

- Drejtor i përgjithshëm i Policisë 73 870 lekë

- Zëvendësdrejtor i përgjithshëm i Policisë 66 890 lekë

- Komandant i Gardës së Republikës 66 890 lekë

IV. Në vendimin nr.726, datë 21.12.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, paragrafi i parë, pika 20 ndryshohet si vijon:

“Për natyrë të veçantë pune, punonjësit civilë në sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes përfitojnë shtesë mbi pagën bazë mujore në masën deri në 32 për qind, ndërsa punonjësit civilë në sistemin e Ministrisë së Rendit Publik në masën deri në 65 për qind.”.

V. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2001, për secilën ministri.

VI. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministria e Mbrojtjes dhe Departamenti i Administratës Publike, që brenda datës 28.2.2001, të paraqesin në Këshillin e Ministrave, për shqyrtim e miratim, studimin përkatës për përmirësimin e sistemit të pagave të ushtrarakëve të Ministrisë së Mbrojtjes.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2001.

KRYEMINISTRI  
Ilir Meta

**VENDIM**  
**Nr. 17, datë 12.1.2001**

**PËR MIRATIMIN E PROCEDURËS SË TENDERIMIT, PËR SHITJEN E PAKETËS SË AKSIONEVE, PREJ 94 PËRQINDËSH, TË ZOTËRUAR NGA SHTETI NË “BIRRA MALTO”, SH.A, TIRANË, DHE PËR SHPALLJEN FITUES TË TENDERIT KANDIDATIN E RADHËS, “11 SHOQËRI SHQIPTARE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991, “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private, të pavarura dhe privatizimit”, të nenit 3, të ligjit nr.8334, datë 23.4.1998, “Për privatizimin e shoqërive tregtare që veprojnë në sektorët jostrategjikë“, dhe të kap.XI, pika 4, shkronja “d” të vendimit nr.529, datë 21.8.1998, të Këshillit të Ministrave, “Për privatizimin e shoqërive tregtare që veprojnë në sektorët jostrategjikë“, me ndryshimet përkatëse, me propozimin e kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e procedurës së tenderimit, për shitjen e paketës së aksioneve prej 94 përqindësh, të zotëruar nga shteti në “Birra Malto”, sh.a., Tiranë, dhe për shpalljen fitues të tenderit kandidatit “11 shoqëritë shqiptare”.

3. Vendimi nr.491, datë 19.9.2000, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e procedurës së tenderimit për shitjen e paketës së aksioneve në “Birra Malto”, sh.a., Tiranë dhe shpalljen fitues të tenderit të “Birra Peroni”, S.p.a” shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Ilir Meta

**VENDIM**  
**Nr. 21, datë 20.1.2001**

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT, PËR STRATEGJINË KOMBËTARE TË STREHIMIT**

Në mbështetje të shkronjës “b”, pika 1 e nenit 59, të nenit 100, të Kushtetutës, dhe të nenit 13, të ligjit nr.8030, datë 15.11.1995, “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, me propozimin e ministrit të Punëve Publike, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e planit të veprimit të strategjisë kombëtare të strehimit.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë, Ministria e Pushtetit Lokal dhe INSTAT-i, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Ilir Meta

**VENDIM**  
**Nr. 35, datë 20.1.2001**

**PËR SHPËRNDARJEN E KËSHILLIT TË KOMUNËS BËRXULLË, NË QARKUN E TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 115 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 26, të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, me propozimin e ministrit të Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

Shpërndarjen e këshillit të komunës Bërxullë, në qarkun e Tiranës.  
Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Ilir Meta

**VENDIM**  
**Nr. 36, datë 20.1.2001**

**PËR SHPËRBLIMIN E PUNËS NË SHOQËRITË TREGTARE, ME KAPITAL TËRËSISHT SHTETËROR, QË E USHTROJNË VEPRIMTARINË E TYRE NË SEKTORIN FINANCIAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999, “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Paga e drejtorit të përgjithshëm të shoqërive tregtare, me kapital tërësisht shtetëror, që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sektorin financiar, “INSIG”, sh.a., dhe “Banka e Kursimeve”, sh.a., përcaktohet nga ministri i Financave, në mbështetje të propozimeve të bëra nga këshillat, drejtuese ose mbikëqyrëse, të shoqërive respektive, të quajtura më poshtë “Këshilla”.

2. Këshillat e shoqërive, të parashikuara në pikën 1 të këtij vendimi, përcaktojnë sistemin e pagave dhe të shpërblimeve të punonjësve. Ky sistem të ndërtohet duke iu referuar sistemit të pagave dhe të shpërblimeve të punonjësve në administratën publike. Raporti i pagës minimale me pagën e drejtorit të përgjithshëm të përcaktohet duke iu referuar raportit të pagës minimale me pagën maksimale në administratën publike, por, në asnjë rast, të mos kalojë raportin 1:9.

3. Këshillat i propozojnë ministrit të Financave fondin e shpërblimeve për punonjësit e tyre. Shpërblimet për punonjësit jepen pas nxjerrjes së rezultateve financiare, çdo 3 ose 6 muaj.

Ministri i Financave përcakton shpërblimet për organet drejtuese të shoqërive tregtare, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sektorin financiar.

4. Në pikën 8 të vendimit nr.317, datë 8.7.1999, të Këshillit të Ministrave, “Për shpërblimin e punës të punonjësve”, fjalët “Drejtori i INSIG”, dhe “Drejtor i Bankës së Kursimeve”, hiqen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Ilir Meta

**VENDIM**  
**Nr. 38, datë 26.1.2001**

**PËR NJË MBROJTJE TË VEÇANTË TË PERSONAVE, QË NDIHMOJNË POLICINË, DHE TË PUNONJËSVE TË POLICISË, QË U KËRCËNOHET JETA, FAMILJA DHE PRONA, PËR SHKAK TË DETYRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 34, dhe të pikës 2, të nenit 57, të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999, “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Policia e Shtetit siguron mbrojtje të veçantë për:

a) personat që u kërcënohet jeta, familja dhe prona, për shkak të të dhënave që i japin policisë, për ngjarje ose autorë veprash penale;

b) punonjësit e policisë, të cilëve, për shkak të detyrës, u kërcënohet jeta, prona dhe familja.

Me mbrojtje të veçantë, në këtë vendim, do të kuptohen masat, me karakter organizativ dhe profesional, për ruajtjen fizike të personave të përmendur në shkronjat “a” dhe “b”, që në vijim do të quhen “persona të kërcënuar”.

2. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit të përcaktohen, me urdhër të ministrit të Rendit Publik, struktura që do të merret me çështjet e mbrojtjes së veçantë të personave të kërcënuar dhe detyrat funksionale të kësaj strukture.

3. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë krijohet komisioni i posaçëm (KVK), me këtë përbërje:

a) Zëvendësdrejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit..... kryetar

b) Drejtori i Policisë Kriminale.....anëtar

c) Shef i strukturës, që do të caktohet sipas pikës 2 të këtij vendimi.....anëtar

ç) Drejtori i policisë së qarkut ku banon personi i kërcënuar..... anëtar

d) Drejtori i Forcave Sociale e të Ndërhyrjes së Shpejtë.....anëtar,

i cili shqyrton kërkesat për mbrojtje të veçantë të paraqitura nga:

- drejtoria e policisë së qarkut;

- personi i kërcënuar apo përfaqësuesi i tij ligjor;

4. Kërkesa, që i paraqitet komisionit të vlerësimit të kërcënimeve, duhet të përmbajë:

a) gjenealogjet e plotat të subjektit që kërcënohet;

b) rrezikshmërinë e theksuar shoqërore të kërcënimeve;

c) shkaqet e kërcënimit dhe rrethanat e tjera, që e detyrojnë subjektin të paraqesë kërkesën.

5. Komisioni i vlerësimit të kërcënimeve, brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës për mbrojtje të veçantë, vendos:

a) Pranimin e kërkesës.

Në këtë rast përcakton edhe masat konkrete të mbrojtjes, të cilat kanë të bëjnë me:

- ruajtjen fizike;

- ruajtjen e banesës a të pronës së personit;

- transferimin e tij;
- dërgimin jashtë shtetit;
- masa të tjera të varësi të çështjes.

b) Mospranimin e kërkesës.

6. Vendimi i komisionit të vlerësimit të kërcënimeve miratohet nga drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit dhe përmban:

a) Pjesën hyrëse, d.m.th, subjektin që ka bërë kërkesën, kohën dhe vendin e marrjes së vendimit, përbërjen emërore të komisionit.

b) Pjesën përshkruese, ku jepen rrethanat që e kanë shtyrë subjektin për të bërë kërkesën, veprën penale të kryer, personalitetin e të kërcënuarit, rrezikshmërinë shoqërore të kërcënimeve dhe vlerësimet për të dhënat që zotërohen rreth një fakti të tillë.

c) Pjesën vendimmarrëse, ku përcaktohen masat konkrete për mbrojtjen e veçantë, kohën, ekzekutuesin e vendimit, afatin e zgjatjes së masave, shpenzimet dhe subjektin që do t'i përballojë këto shpenzime.

7. Kundër vendimit për mospranimin e kërkesës bëhet ankim, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit, te ministri i Rendit Publik, vendimi i të cilit është përfundimtar.

8. Vendimi i komisionit të vlerësimit të kërcënimeve zbatohet nga struktura përkatëse, e ngarkuar për këtë qëllim, sipas pikës 2 të këtij vendimi.

9. Shpenzimet për realizimin e mbrojtjes së veçantë përballohen nga buxheti i Ministrisë së Rendit Publik, ose nga subjekti shtetëror, që ka paraqitur kërkesën.

10. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

11. Ngarkohet ministri i Rendit Publik për kontrollin e zbatimit të këtij vendimi dhe për miratimin e akteve në zbatim të tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Ilir Meta

## VENDIM

Nr. 39, datë 26.1.2001

### **PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.726, DATË 21.12.2000, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 dhe 6, të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999, "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale dhe të ministrit të Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave

#### V E N D O S I:

Në vendimin nr.726, datë 21.12.2000, të Këshillit të Ministrave bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 4 shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

"Në varësi me numrin e popullsisë, shtrirjen territoriale dhe nivelin e zhvillimit ekonomik-social, kategorizimi i qarqeve, i bashkive e i komunave, për efekt page të punonjësve, bëhet nga ministri i Pushtetit Lokal dhe miratohet nga kryeministri."

2. Në lidhjen II-A "Shtesat mbi pagë për funksione drejtuese", në kreun II "Shtesa të tjera", pas pikës 22 shtohet pika 23, me këtë përmbajtje:

"24. Drejtuesve dhe specialistëve të Drejtorisë së Kontroll-Mbikëqyrjes dhe Drejtorisë së Shpronësimeve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, për natyrë të veçantë pune u jepet një shtesë mbi pagën bazë në masën 30 për qind."

3. Në lidhjen II-A "Shtesa mbi pagë për funksione drejtuese", në kreun II "Shtesa të tjera", bëhen këto plotësime:

“Në fund të pikës 3 shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:  
“Në prefektura, revizorët (inspektorët e kontrollit) 35-40 për qind dhe drejtuesve të tyre 10 për qind. Këta punonjës nuk përfitojnë shtesën mbi pagë, të përcaktuar në pikën 11 të kësaj lidhjeje.””.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Ilir Meta

**VENDIM**  
**Nr. 40, datë 26.1.2001**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.198, DATË 4.5.1993, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E ENTIT KOMBËTAR TË BANESAVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 3 të ligjit nr.7582, datë 13.7.1992, “Për ndërmarrjet shtetërore”, me propozimin e ministrit të Punëve Publike, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

Në vendimin nr.198, datë 4.5.1993, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 2 shtohen shkronjat “b/1”, “f”, “g” dhe “h”, me këtë përmbajtje:

“b/1. Bën studime dhe projektme të plota në fushën e banesave, përfshirë dhe urbanizimin e shesheve të ndërtimit”.

“f. Blerje trojesh, në tregun e lirë, për ndërtim banesash”.

“g. Blerje dhe shitje banesash, në tregun e lirë, për kategorinë e të pastrehëve dhe të qytetarëve, me status të veçantë, të përcaktuar me aktet, ligjore e nënligjore”.

“h. Dhënie me qira të banesave, deri në shitjen e tyre”.

2. Në pikën 3 bëhen këto ndryshime:

- Paragrafi i parë dhe i dytë hiqen dhe zëvendësohen me:

“Këshilli Drejtues përbëhet nga 7 anëtarë, dhe konkretisht:

- Përfaqësues nga aprati i Këshillit të Ministrave.....1

- Përfaqësues nga Ministria e Punëve Publike.....4

- Përfaqësues nga Ministria e Financave.....1

- Përfaqësues nga Ministria e Pushtetit Lokal.....1

Kryetari dhe anëtarët e Këshillit Drejtues propozohen nga ministria përkatëse dhe emërohen nga ministri i Punëve Publike.

Këshilli drejtues gëzon të drejtën e shpërblimit, në përputhje me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave”.

- Në paragrafin 4, fjalia e dytë ndryshohet dhe zëvendësohet me:

“Në bazë të propozimeve të drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues zgjedh drejtorët e drejtorive në Drejtorinë e Përgjithshme, drejtorët dhe kryetarët rajonalë ndërmjet të paktën 2 kandidaturave”.

3. Pas pikës 4 shtohet 4.1 me këtë përmbajtje:

“Për rastin e banesave të ndërtuara me fonde shtetërore, nëpërmjet EKB-së, ky i fundit vepron si agent-shitës dhe pronar me të drejta të plota mbi banesë, deri në shlyerjen e plotë të detyrimeve financiare që qytetarët do të kenë për këto banesa.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Ilir Meta

**VENDIM**  
**Nr. 43, datë 26.1.2001**

**PËR KALIMIN NË PRONËSI PA SHPËRBLIM, TË 51 PËR QIND TË AKSIONEVE TË SHOQËRISË “SHTYPSHKRONJA TIRANA”, SH.A., NË TIRANË, PËR KRYEGJYSHATËN BOTËRORE TË BEKTASHINJVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 23, të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991, “Për sanksionimin e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit” ndryshuar me ligjin nr.8159, datë 7.11.1996, “Për miratimin me ndryshime të dekretit nr.1632, datë 1.1.1996, “Për disa ndryshime në ligjin nr.7512, datë 10.8.1991””, me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Kalimin në pronësi pa shpërblim të 51 për qind të aksioneve të shoqërisë “Shtypshkronja Tirana”, Sh.a., në Tiranë, për Kryegjyshatën Botërore të Bektashinjve.
2. Në vendimin nr.78, datë 21.1.1999, të Këshillit të Ministrave, “Për ruajtjen e pronësisë shtetërore në disa shoqëri tregtare dhe ndërmarrje”, nga lista e ndërmarrjeve shtetërore, shoqërive anonime dhe shoqërive të përbashkëta në të cilat ruhet pjesëmarrja e kapitalit shtetëror, shfuqizohet pika 9.
3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Agjencia Kombëtare e Privatizimit për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**

**VENDIM**  
**Nr. 49, datë 26.1.2001**

**PËR SKEMËN E SHTYRJES SË PAGESËS SË TVSH-SË DHE PËRCAKTIMIN E KATEGORISË SË EKSPORTUESVE, QË PËRFITOJNË RIMBURSIMIN, BRENDË 30 DITËVE, TË TVSH-SË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 26 dhe 50, të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar edhe me ligjin nr.8714, datë 15.12.2000, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

- I. PËR SISTEMIN E SHTYRJES SË PAGESËS SË TVSH-së**
1. Ndaj çdo objekti të tatueshëm me TVSH, i cili importon pajisje apo makineri, për t’i investuar po vetë në njërin nga fushat e përcaktuara në pikën 5 të këtij vendimi, zbatohet sistemi i shtyrjes së pagesës për tatimin mbi vlerën e shtuar. Importimi dhe investimi kryhen nga i njëjti subjekt.
  2. Subjektet e tatueshme me TVSH, që importojnë makineri dhe pajisje për t’u investuar në prodhim, ndërtim, telekomunikacion dhe KESH, identifikohen dhe klasifikohen me të drejtën e shtyrjes së pagesës, me kërkesën e tyre apo kryesisht.
  3. Përfitojnë lehtësitë e parashikuara në pikën 1 të këtij vendimi, vetën subjektet që importojnë makineri dhe pajisje, që i takojnë linjës teknologjike apo që lidhen, drejtpërdrejtë, me procesin teknologjik përkatës.

4. Për qëllime të zbatimit të dispozitave të këtij vendimi:

a) me fjalën “makinë“ do të kuptohet çdo konstruksion i krijuar prej njeriut, që, duke marrë energji në një formë të përshtatshme, si dhe instruksionet e duhura, është në gjendje të kryejë punë. Një sistem makinash, të lidhura sipas një skeme të përcaktuar, përbëjnë atë që quhet “makineri”.

b) me shprehjen “linjë teknologjike” do të kuptohet tërësia e makinerive dhe e pajisjeve, që nevojiten për të realizuar procesin teknologjik në fushën përkatëse, ku do të bëhet investimi.

c) me shprehjen “proces teknologjik”, do të kuptohet tërësia e metodave që duhen të ndiqen, hap pas hapi, për të bërë të mundur kryerjen e qëllimit, për të cilin bëhet investimi përkatës.

ç) me fjalën “pajisje” do të kuptohen pajisjet dhe aparaturat, që shërbejnë si plotësuese të makinerive dhe që ndihmojnë për funksionimin e rregullt të tyre, si dhe për matjen dhe kontrollin e parametrave të punës.

5. Investimet që përfitojnë nga lehtësitë e parashikuara në pikën 1 të këtij vendi, duhet të kryhen të paktën në njërën nga fushat e mëposhtme:

a) Në prodhim, me të cilin do të kuptohet instalimi i makinerive dhe i linjave teknologjike, për të realizuar shfrytëzimin e pasurive natyrore (përfshirë ato ujore), rritjen e bimëve dhe të kafshëve dhe përpunimin industrial të lëndëve të para e të gjysmëprodukteve.

b) Në ndërtim, me të cilin do të kuptohet ngritja e parkut të makinerive dhe të pajisjeve, të nevojshme për të realizuar sipërmarrje ndërtimore.

c) Në telekomunikacion, me të cilat do të kuptohet instalimi i centraleve dhe i sistemeve të antenave, i linjave dhe i aparatrave të nevojshme, për të realizuar telekomunikimin masiv.

6. Makineritë dhe pajisjet e subjektit që ka fituar lehtësitë e parashikuara në pikën 1 të këtij vendimi, duhet të regjistrohen në llogarinë e mjeteve themelore të investitorit.

7. Kur tatimpaguesit e TVSH-së importojnë makineri dhe pajisje, sipas klasifikimit të bërë në këtë vendim, atyre u lejohet shtyrja e pagesës së TVSH-së mbi importet deri në çastin e dorëzimit të deklaratës përkatëse të TVSH-së. Kjo do të thotë se kjo kategori mallrash nuk i nënshtrohet pagimit të TVSH-së në doganë.

8. Në këto raste, importuesit bëjnë menjëherë një faturë tatimore shitjeje (brenda vendit) për të njëjtën vlerë të makinerive dhe të pajisjeve të importuara nën skemën e shtyrjes së pagesës, ku shitësi dhe blerësi është i njëjti person. Ko faturë regjistrohet në librin e shitjeve dhe të blerjeve.

9. Nëse importuesi gëzon të drejtën e 100 për qind të kreditimit tatimor për blerjet (d.m.th. makineritë dhe pajisjet e importuara do t'i shërbejnë krejtësisht veprimtarisë së tatueshme), TVSH-ja, e zbatueshme në importe, do të zbritet e tëra nga po e njëjta shumë TVSH-je, e llogaritur mbi shitjet, sipas pikës 8 të vendimit. Në të kundërt, do të zbatohet paragrafi “Kreditim i pjesshëm”, i udhëzimit të ministrit të Financave, “Për TVSH-në”.

10. Në deklaratën përkatëse të TVSH-së, vlera e tatueshme në import, e makinerive dhe e pajisjeve, dhe TVSH-ja e llogaritur për këto mallra, raportohen në kutitë përkatëse të importit (14 e 15 të Formularit të Deklarimit të Pagesës) dhe në të njëjtën deklaratë raportohen si shitje brenda vendit dhe si TVSH e llogaritur mbi këto shitje (11 e 12 të Formularit të Deklarimit të Pagesës) dhe në të njëjtën deklaratë raportohen si shitje brenda vendit dhe si TVSH e llogaritur mbi këto shitje (11 e 12 të Formularit të Deklarimit të Pagesës).

11. Tatimpaguesi, që përfiton nga kjo skemë, detyrohet të dorëzojë në degën e tatimeve ku është i regjistruar, brenda datës 14 të muajit pasardhës, përveç Formularit të Deklarimit të Pagesës edhe dokumentet e mëposhtme, në dy kopje:

- kopje të faturës së shitjes, të hartuar siç është përshkruar më lart;
- kopje të librit të shitjes dhe të blerjes, të periudhës përkatëse tatimore;
- kopje të deklaratës doganore të importit.

Në degën e doganës përkatëse, për të mbyllur llogaritë kontabël të importimeve, tatimpaguesi dorëzon, brenda datës 25 të muajit pasardhës, një kopje të çdo dokumenti të mëposhtëm:

- kopje të faturës së shitjes, të hartuar siç është përshkruar më lart;
- kopje të librit të shitjes dhe të blerjes, të periudhës përkatëse tatimore;
- kopje të Formularit të Deklarimit të Pagesës.

Të gjitha këto dokumente duhet të jenë të vulosura nga zyra e TVSH-së. Mosdërgimi i dokumentacionit të plotë në zyrat e doganës, u jep të drejtë organeve doganore të pezullojnë zbatimin e kësaj skeme.

## II. KATEGORIZIMI I EKSPORTUESVE

1. Për qëllime të përfitimit të rimbursimit, sipas pikës 4 të nenit 50 të ligjit nr.8714, datë 15.12.2000, do të quhen eksportues ajo kategori tatimpaguesish, që:

a) eksporton sipas kuptimit të neneve 181 dhe 182, të Kodit Doganor;

b) vlera e eksporteve të bëra në një muaj përbën më shumë se 50 për qind të vlerës totale të shitjeve, duke përfshirë eksportet.

2. Teprica kreditore, që do të kërkohet si e rimbursueshme, duhet të plotësojë dy kushte njëkohësisht:

a) të llogaritet si produkt i koeficientit N me totalin e TVSH-së së paguar në blerje, ku N të jetë i madh se 50 për qind.

$N = \text{Vlera totale e eksporteve të një muaji}$

$\text{Vlera totale e shitjeve të një muaji (përfshi eksportet)}$

b) të jetë më shumë se 400 000 lekë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Ilir Meta**

## VENDIM

**Nr. 50, datë 26.1.2001**

### **PËR MIRATIMIN E MANUALIT KONTABËL TË BANKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 3, shkronja “b”, paragrafi i dytë, i ligjit nr.7661, datë 19.1.1993, “Për kontabilitetin”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

#### V E N D O S I:

Miratimin e manualit kontabël të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Ilir Meta**

## VENDIM

**Nr. 51, datë 26.1.2001**

### **PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I SUPERSTRADËS SUKTH-DURRËS, NË RRETHIN E DURRËSIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 dhe 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit, Këshilli i Ministrave

#### V E N D O S I:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pasurive të paluajtshme të pronarëve, që preken nga ndërtimi i superstradës Sukth-Durrës, në rrethin e Durrësit.

2. Shpronësmi bëhet në favor të Ministrisë së Transportit.

3. Pronarët e këtyre pasurive të paluajtshme, me sipërfaqe të përgjithshme 28 676 m<sup>2</sup>, që do të shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, në masën përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, e që arrin shumën e përgjithshme prej 34 411 200 (tridhjetekatër milionë e katërqindnjëmbëdhjetë mijë e dyqind) lekësh.

4. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2001, zëri “Shpronësime”, miratuar për Ministrinë e Transportit.

5. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 31.1.2001.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Ilir Meta

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
RRETHI DURRËS  
KOMUNA XHAFZOTAJ

Fshati Sallmone

Lista e personave që shpronësohen për efekt të ndërtimit të superstradës Sukth-Durrës

Lloji i pasurisë së paluajtshme: Tokë bujqësore

1	2			3		4	5		6	7	8
Nr	Emër	Atësi	Mbiem	Nr. akti	Parc.	Nr.km	Gjat (ml)	Gjer (ml)	Sip. (m <sup>2</sup> )	Çmimi L/m <sup>2</sup>	Total lekë)
1	Ibrahim	Baram	Bulku	374	86/6	12+35312+400	6	10	60		
2	Ibrahim	Baram	Bulku	374	86/6	12+353-12+400	11.5	8.7	100		
3	Rexhep	Avdulla	Golemi	320	86/3	12+353-12+400	14	11.5	161		
4	Luan	Zyber	Bulku	360	86/2	12+353-12+400	22.5	4	90		
5	Skënder	Xhemal	Meta	403	85/12	12+400-12+500	85	4.6	382		
6	Ilmi	Riza	Vezi	330	85/11	12+450-12+550	82	6.3	1027		
7	Reshit	Haxhi	Dervishi	192	85/10	12+500-12+600	76	4.5	342		
8	Asllan	Shaban	Shahini	162	85/17	12+500-12+600	108	6.5	702		
9	Ilmi	Riza	Vezi	330	85/11	12+500-12+600	77.4	3.5	26		
10	Isa	Islam	Meta	397	85/13	12+353-12+400	8.6	3.5	30		
11	Ramazan	Hasan	Cyrbja	230	87/28	12+700-12+800	53	4.8	254		
12	Fadil	Ibrahim	Bulku	221	87/29	12+800-12+900	57.5	6.5	374		
13	Rexhep	Ramadan	Previzi	222	87/32	12+800-12+900	47	2.5	118		
14	Haxhi	Rush	Previzi	168	87/31	12+700-12+800	66	5	330		
15	Fatmir	Delip	Bulku	167	87/34	12+800-12+900	50	1.5	75		
16	Mustafa	Ali	Vezi	197	87/24	12+600-12+700	17	3	51		
17	Shaban	Ali	Vezi	199	87/26	12+600-12+700	49.5	6.3	312		
18	Haxhi		Dervishi	192	85/9	12+600-12+700	55.7	7.2	401		
19	Basri	Shaban	Vezi	196	87/25	12+700-12+800	39.6	6.2	245		
20	Rruzhdhi	Hasan	Cyrbja	239	87/27	12+700-12+800	40	5.5	220		
21	Ramazan	Hasan	Cyrbja	230	87/28	12+600-12+700	14	2.5	35		
22	Fadil	Ibrahim	Bulku	221	87/29	12+800-12+900	41	4	164		
23	Ruzhdi	Sherif	Kuci	127		12+800-12+900	23	4.5	104		
24	Sulejman	Ramadan	Kuci	105		13+050-13+100	37.5	5.5	206		
25	Hamdi	Myslym	Kuci	109	88/42	13+100-13+100	38	7	266		
26	Gani	Myslym	Kuci	110	88/40	12+850-13+050	46.5	5.5	256		
27	Nazmi	Myslym	Kuci	120	88/41	12+950-13+000	52	5.3	276		
28	Zeliha	Islam	Kuci	103	88/44	13+100-13+150	42	4	168		
29	Nuhi	Mehmet	Murati	3255	88/15	12+900-12+950	40	4.5	180		
30	Hariz		Kuci			13+100-13+400	52	11.5	598		
31	Ruzhdi	Sherif	Kuci	127		13+300-13+500	145	15.4	2233		

32	Ferik	Hysni	Bici	129		13+400-13+600	125	12.4	1550		
33	Bujar	Hysni	Bici	86		13+600-13+650	66.5	1.	665		
34	Lulëzim	Xhelal	Memoci	57		13+600-13+800	130	4.5	585		
35	Ramiz	Fejzulla	Memoci	55		13+800-13+900	125	1.8	225		
36	Qemal	Fejzulla	Memoci	54		13+700-13+900	210	1.1	231		
37	Hariz	Ymer	Keci	102		13+000-14+000	97	13.9	1348		
38	Qamil	Ruh	Previzi	276		12+800-12+900	13	1	13		

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

RRETHI DURRËS

KOMUNA XHAFZOTAJ

Fshati Sallmone

Lista e personave që shpronësohen për efekt të ndërtimit të superstradës Sukth-Durrës

Lloji i pasurisë së paluajtshme: Tokë bujqësore

1	2			3		4	5		6	7	8
Nr	Emër	Atësi	Mbiem	Nr. akti	Parc.	Nr.km	Gjat (ml)	Gjer (ml)	Sip. (m2)	Çmimi L/m2	Total lekë)
39	Mustafa	Sulejman	Calliku	115		14+800-15+100	100	15.6			
40	Miftar	Sulejman	Calliku	110		14+800-15+100	100	1587			
41	Halit		Nerjaku	5		14+000-14+100	55	330			

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

RRETHI DURRËS

KOMUNA RRASHBULL

Fshati St.Zot.Xhafzotaj

Lista e personave që shpronësohen për efekt të ndërtimit të superstradës Sukth-Durrës

Lloji i pasurisë së paluajtshme: tokë bujqësore

1	2			3		4	5		6	7	8
Nr	Emër	Atësi	Mbiem	Nr. akti	Parc.	Nr.km	Gjat (ml)	Gjer (ml)	Sip. (m2)	Çmimi L/m2	Total lekë)
42	Imer	Feti	Pasha	244	11/	15.850-15.900	15.0	3.0	45.0		
43	Bujar	Imer	Pasha	116	11/	15.850-15.900	8.0	4.0	32.0		
44	Arap	Reshit	Muka	222	11	15.850-15.900	10.0	6.0	60.0		
45	Selim	Arap	Muka	223	11	15.850-15.900	5.0	8.0	40.0		
46	Reshit	Arap	Muka	224	11	15.850-15.900	8.0	8.8	70.0		
47	Edmond	Zydi	Aruci	221	11	15.850-15.900	10.5	8.8	92.0		
48	Kujtim	Ahmet	Balla	119	11	15.900-16.000	13.0	5.3	69.0		
49	Sami	Ahmet	Balla	86	11	15.900-16.000	10.0	3.0	30.0		
50	Rexhep	Osman	Demalia	41	11	15.900-16.000	15.0	2.0	30.0		
51	Islam	Adem	Krasniqi	215	11	15.900-16.000	23.0	2.0	46.0		
52	Gëzim	Islam	Krasniqi	559	11	15.900-16.000	15.0	1.2	18.0		
53	Rexh	Adem	Krasniqi	206	11	15.900-16.000	10.5	2.0	21.0		
54	Kujtim		Xhafa		11	15.900-16.000	13.0	2.6	34.0		
55	Skënder		Xhafa		11	16.000-16.100	5.0	2.9	14.0		
56	Bedri		Xhafa		11	16.000-16.100	10.0	2.6	26.0		
57	Haxhi	Xhem	Voci		11	16.000-16.100	15.0	1.4	21.0		
58	Arben	Haxhi	Voci	144	11	16.000-16.100	10.5	1.2	13.0		
59	Xheladin	Haxhi	Voci	145	11	16.000-16.100	5.5	1.1	6.0		
60	Shkëlqim	Shaban	Hasani	202	11	16.000-16.100	15.5	1.0	15.0		
61	Servete		Nuho		11	16.000-16.100	8.5	0.9	8.0		

62	Sokrat		Cina		11	16.000-16.100	30.5	0.8	25.0		
63	Fatmir		Binozi		12	15.600-15.800	174.0	2.2	383.0		
64	Zenel	Bajram	Demiraku	16	12	15.600-15.850	71.0	4.1	291.0		
65	Meriban		Demiraku		12	15.600-15.850	60.0	3.0	180.0		
66	Tahir	Bajram	Demiraku	37	12	15.600-15.850	80.0	2.4	192.0		
67	Skënder		Demiraku		12	15.600-15.850	20.0	2.0	40.0		
68	Shefqet	Tahir	Neza	575	13	15.400-15.600	20.0	0.3	6.0		
69	Avdi	Selman	Neza	577	13	15.400-15.600	18.0	0.4	7.0		
70	Dan	Hazir	Neza	576	13	15.400-15.600	16.5	0.9	15.0		
71	Mustafa	Adem	Neza	574	13	15.400-15.600	20.0	1.0	20.0		
72	Bashkim	Hazir	Neza	578	13	15.400-15.600	35.0	1.2	42.0		
73	Ahmet	Niman	Neza	578	13	15.400-15.600	20.0	1.3	26.0		
74	Hysni	Adem	Neza	584	13	15.400-15.600	24.0	1.3	31.0		
75	Veli	Adem	Neza	580	13	15.400-15.600	20.0	1.4	28.0		
76	Haki		Neza	581	13	15.400-15.600	20.0	1.5	30.0		
77	Besnik	Rexhep	Neza	568	13	15.400-15.600	20.0	0.7	14.0		

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
RRETHI DURRËS  
KOMUNA RRASHBULL  
Fshati St.Zot.Xhafzotaj  
Lloji i pasurisë së paluajtshme: tokë bujqësore

1	2			3		4	5		6	7	8
Nr	Emër	Atësi	Mbiemër	Nr. akti	Parc.	Nr.km	Gjat (ml)	Gjer (ml)	Sip. (m2)	Çmimi L/m2	Total lekë)
78	Fadil	Sulejman	Neza	566	13	15.400-15.600	27.0	1.0	27.0		
79	Sali		Neza		13	15.400-15.600	32.5	1.3	42.0		
80	Agim	Rexhep	Neza	570	13	15.400-15.600	29.5	1.5	44.0		
81	Rustem	Haxhi	Neza	571	13	15.400-15.600	24.0	1.6	38.0		
82	Qamil	Haxhi	Neza	573	13	15.400-15.600	34.0	1.8	61.0		

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
RRETHI DURRËS  
KOMUNA RRASHBULL  
Fshati Shenavlash  
Lista e pasurisë së paluajtshme: tokë bujqësore

1	2			3		4	5		6	7	8
Nr	Emër	Atësi	Mbiem	Nr. akti	Parc.	Nr.km	Gjat (ml)	Gjer (ml)	Sip. (m2)	Çmimi L/m2	Total lekë)
83	Sotir	Dhimitër	Prifti	492	278/4	16+500-16+650	85	1.7	144		
84	Avdi	Ramadan	Lika			16+650-16+800	197	3	591		
85	Qemal	Mehmet	Berxhilla			16+800-16+900	80	13	1.40		
86	Mehmet	Rustem	Hoxha	3339	278/27	16+800-16+900	30	10.3	3.8		
87	Muharrem	Rustem	Hoxha	493	278/13	16+900-17+100	43	7	3.0		
88	Ismail	Rustem	Hoxha	3339	278/13	16+900-17+100	117	10.1	1182		
89	Muharrem	Rustem	Hoxha	493	278/13	16+900-17+100	11.5	6	69		
90	Mehmet	Rustem	Hoxha	3339	278/2	17+100-17+250	145	12.2	1769		
91	Qemal	Shaqir	Loka	666	290	17+200-17+300	99.6	1	100		
92	Isuf	Ahmet	Alia	644	290/1	17+200-17+300	30.2	1.5	45		
93	Jediqar	Teki	Tora	488	290	17+400-17+600	170	12.4	2113		
94	Jediqar	Teki	Tora		297	17+600-17+800	190	4.8	907		

**UDHËZIM**  
**Nr. 1, datë 12.1.2001**

**NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR.4, DATË 22.8.1994, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,**  
**“PËR VLERËSIMIN E APARTAMENTEVE, QË NDËRTOHEN ME FONDE**  
**SHTETËRORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**U D H Ë Z O J:**

Në pikën 9 të udhëzimit nr.4, datë 22.8.1994, të Këshillit të Ministrave, shtohet shkronja “d”, me këtë përmbajtje:

“d. Për ushtarakët, që apartamentet e mëparshme ia kalojnë në pronësi Entit Kombëtar të Banesave, çmimi i shitjes së apartamenteve, të filluar para vitit 1993 me fondet e Ministrisë së Mbrojtjes dhe të përfunduara nga Enti Kombëtar i Banesave ose Ministria e Mbrojtjes, të llogaritet mbi bazën e vlerës reale të apartamentit, në pallat, që do të blejë, duke zbritur vlerën që u takon punimeve të kryera para 1.1.1993 dhe vlerën e apartamentit që dorëzon.

Në rastet kur çmimi i apartamentit, në pallat, që dorëzohet është më i madh se çmimi i apartamentit që merret nga EKB-ja, kjo e fundit nuk merr përsipër pagesën e diferencës”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**

Fletorja Zyrtare gjendet në:

1. Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
2. Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare,  
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 31.1.2001  
Doli nga shtypi më 5.2.2001

Tirazhi: 3700 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Çmimi 150 lekë